



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of  
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

**DPL.nr. 31/2021**

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe znj. Myjesere Mujku, anëtare të Komisionit Disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat [REDACTED] si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, dhe pas seancës këshillimore dhe të votimit, me datën 09.11.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**KONSTATOHEN** të tërhequra Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-31/2021, datë 05.10.2021 si dhe Propozimi për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat [REDACTED] i datës 21.09.2021, i paraqitur nga [REDACTED] Kryetar i Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Me datën 21.09.2021, [REDACTED], Kryetar i Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës ka paraqitur Propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat [REDACTED] si organ përmbarues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED], pasi që i njëjti nuk i ka përbushur të gjitha detyrimet për anëtarësi ndaj Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës për vitin 2020. Sipas propozimit, administrata e Odës disa herë ka dërguar kërkesa përmes adresës elektronike tek përmbaruesi privat, ai është kontaktuar edhe përmes telefonit si dhe janë shfrytëzuar kuvendet ose trajnimet për t'ia rikujtuar obligimin për të përbushur detyrimet në pajtim me vendimin e Kuvendit të Odës së Përmbaruesve të Kosovës të dt 04.03.2021, por i njëjti

ka paguar një pjesë të detyrimeve ndërsa pjesën tjetër të detyrimit edhe pse ka premtuar nuk e ka përmbushur.

Me datën 05.10.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj përmbartuesit privat [redacted] si organ përmbartues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted]

Përmbartuesi privat [redacted] në përgjigjen e tij me shkrim me dt 12.10.2021 ka njoftuar Komisionin se ka përmbushur detyrimin e tij si dhe ka bashkangjitur provat se detyrimi është përmbushur me dt 08.10.2021.

Me datën 05.11.2021, Komisioni Disiplinor ka pranuar Kërkesën nr.08-1775 nga kryetari i Odës së Përmbartuesve Privat të Kosovës. Sipas kërkesës, pasi që përmbartuesit privat [redacted] ka përmbushur detyrimet e tij lidhur me pagesat e kontributeve, parashtruesi konform nenit 366 dhe 367 par 1.11, të Ligjit për Procedurën Përmbartimore tërhiqet nga propozimi për fillimin e procedurës disiplinore.

Me datën 09.11.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ndërsa përmbartuesi privat, [redacted] dhe përfaqësuesi i Odës së Përmbartuesve Privat të Kosovës edhe pse ishin të njoftuar nuk kanë prezantuar.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj. Fadilete Hoxha ka theksuar se pasi që paraqitësi i propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ka njoftuar Komisionin Disiplinor se përmbartuesi privat [redacted] ka përmbushur detyrimet e tij dhe tërheqin propozimin, atëherë, edhe Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat tërhiqet nga Raporti përfundimtar DPL. Nr 31/21, dt 05.10.2021, i paraqitur në Komision Disiplinor.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT**  
**DPL.nr 31/2021, datë 09.11.2021**

**Kryesues i Komisionit Disiplinor**  
**Adnan ISUFI**



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.